



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**KOMUNA E MITROVICËS SË JUGUT**  
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica Sou...

**KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**

Nr. 02-060/21-0084295/dt. 08.09.22  
Mitrovicë

**NJOFTIM**

Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 68.3 i Ligjit Nr.03L-40 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës; nenin 61 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-048 Për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë; në nenin 25 dhe 26 të Statutit të Komunës; nenit 6 pika 1.2, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 Për standardet minimale të konsultimit publike në Komuna; bazuar në Rregulloren Komunale për Transparencë, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës Znj.Vesa Broja në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, Drejtorinë për buxhet dhe financa dhe Zyrën për informim ORGANIZON:

**KONSULTIM PUBLIK**

**PËR**

**PROJEKT BUXHETIN E KOMUNES SË MITROVICËS SË JUGUT PËR VITIN 2023**


Njoftohen të gjithë qytetarët, grupet e interesit dhe palët tjera të interesuara që të marrin pjesë në Konsultimin Publik për Projekt buxhetin e Komunës së Mitrovicës së Jugut për vitin 2023,

Konsultimi publik do të mbahet të enjten më dt. **22.09.2022** në Sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës duke filluar nga ora 14.<sup>00</sup>.

Njëkohësisht të gjithë qytetarët dhe të interesuarit tjerë në afatin prej 15 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi të gjitha propozimet, komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe pikëpamjet mund t'i bëjnë përmes ueb faqes së Komunës <https://kk.rks-gov.net/mitrovicjeejugut/> ose drejtpërdrejtë në Zyrën pritëse dhe Zyrën Nr. 60 të Sekretarisë së Kuvendit të Komunës, ku edhe mund të merret Projekt buxheti për vitin 2023.

Projekt buxhetin e Komunës së Mitrovicës së Jugut për vitin 2023 poashtu mund ta gjeni të publikuar ne ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut duke klikuar linkun: <https://kk.rks-gov.net/mitrovicjeejugut/category/shpalljet/njoftimet/>

Mitrovicë

për   
Kryesuesja e Kuvendit  
Vesa Broja

